

VENDIM
Nr.1470, datë 5.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË TEPELENË, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.467, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Tepelenë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
31-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1-17	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
53-66,73,74-77,93-108	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
1181-1183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
142-144	Varrezat publike	Në pronësi
416-1156 (vetëm troje të lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
18-23,67-72,145-238,240-415,416-1156 (vetëm sheshet dhe lulishtet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
109-141	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit	Në pronësi

	dhe mbrojtjes civile	
1358	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1357	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi